



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:030483

Datë: 06.11.2018

Numri i dokumentit: 00164249

**P.nr.613/17**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S.G. nga Gj., për shkak të veprës penale, të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.361/2017, të datës 26.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë me datën **06.11.2018,** në prezencën e Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuares K.-Gj., po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari **S.G.,** i biri i F., i nënës N., e gjinisë M., data e lindjes ... në M., e tani me banim në Gj., Rr.N.T. nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar-atë i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë s h t ë f a j t o r:

**Sepse:** Nga data e pavërtetuar e gjer me dt.20.09.2016, në shtëpinë e tij në Gj., me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr 5/L-065 të Ligjit për energjinë elektrike të GZRK nr 26/21, korrik 2016, në atë mënyrë që pa njehsorë elektrik përmes kabllor ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së regjistruar gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të distriktit në Gjakovë me rastin e kontrollës, me çrast të dëmtuarës K.-D. i Rr. – D. në Gj. i ka shkaktuar dëm në shumën prej 432.63 Euro.

- me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4, 17 par.1, 41, 46, 49, 50, 51, 52 par.5, 73, dhe nenit 320 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton;

**DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **20 Euro**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara K. – D. në Gj. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.361/2017, të datës 26.09.2017, kundër të akuzuarit S.G. nga Gj. akova, për shkak të veprës penale, të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së. Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari S.G. në shqyrtimin fillestar nuk e ka pranuar fajësinë, për veprën penale me të cilën ngarkohet. Pasi që i njëjti nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, gjykata e njofton se deri në shqyrtimin e dytë gjyqësor në afat prej 30 ditësh mund të paraqet kundërshtim kundër provave të precizuara në aktakuzë si dhe kërkesë për hudhie të aktakuzës.

Në shqyrtimin e dytë gjyqësor të dt:06.11.2018, Gjukata konstaton se i akuzuari gjer në shqyrtimin e dytë gjyqësor nuk ka paraqitur kundërshtim ndaj provave të precizuara në aktakuzë si dhe nuk ka paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Në shqyrtimin e dytë gjyqësor i akuzuari S.G. deklaron se me vullnet të lirë dhe pa presion duke ditur më parë për pasojat dhe favorin e pranimit të fajësisë, e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë dhe tani atë kablllo e kam eliminuar dhe jam shfrytëzues i rregullt i energjisë elektrike dhe pagues i rregullt, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam i pa punë, për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale dhe premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartë përmendura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj deklaron se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkangjitur aktakuzës.

Në shqyrtimin e dytë gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari S.G.: Nga data e pavërtetuar e gjer me dt.20.09.2016 në objektin në ndërtim i cili gjendet në Gjakovë Rr."N.T."..., me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshëm në kundërshtim me dispozitat e nenit 39 të Ligjit për energjinë elektrike të R.së Kosovës, pa autorizim ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që pa njehsor elektrik përmes kablllos është lidhur direkt në rrjetin elektrik, ashtu që ka pamundësuar kështu regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar K.-D. Gj. i ka shkaktuar dëm në shumë prej 432.63 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin e dytë vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i 3 fëmijëve, gjendjen e tij të dobët ekonomike, mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë penale, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhure me nenin 453 par.1. të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.613/17 me datën 06.11.2018**

**Procesmbajtësja,**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
**Diana Sina**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:030483  
Datë: 06.11.2018  
Numri i dokumentit: 00164249